

BASHKIA POGRADEC

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor:

Emri	Bashkia Pogradec
Adresa	Lagjja nr 2, bulevardi "Reshit Çollaku"
Tel/Fax	083222222
E-mail	bashkiapogradec@gmail.com
Faqja e Internetit	www.app.gov.al
Personi Përgjegjës	Nexhmi TORRA
Cel	083222222
E-mail	erindakamburi29@hotmail.com
Adresa	Lagjja nr 2, bulevardi "Reshit Çollaku"

2. Lloji i procedurës së prokurimit: "Procedurë e Hapur" - "Mbi kufirin monetar" - "Shërbime" - "Prokurim Elektronik".

3. Objekti i kontratës: "Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të qytetit Pogradec dhe Njësive Administrative".

4. Numri i referencës së procedurës: REF-46811-12-26-2019.

5. Fondi limit: 625 000 000 (Gjashtëqind e njëzet e pesë milion) lekë, me burim financimi "Të ardhurat - Vetëfinancim", i miratuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë Pogradec Nr. 109, datë 22.11.2019, i konfirmuar me shkresën Nr. 1532/1 prot, datë 27.11.2019, të Prefektit të Qarkut Korçë.

6. Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 5 (Pesë) vjet me aryetimin si më poshtë:

6.1 Referuar pikës 3 të nenit 76 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", (e ndryshuar).

6.2 Kontrata e shërbimit me afat shumevjeçar (5-vjeçar) do të japë mundësi kontraktuesit që të kryejë shërbimin e plotë dhe cilesor, duke investuar në makineri dhe pajisje teknologjike bashkekohore, me qëllim kryerjen e shërbimit në cilësi shumë cilësore, duke kryer transportin e mbeturinave në fushën e depozitimit të tyre dhe duke qenë se mjetet do të jenë për një kohë të gjatë i jepet mundësia për përmirësim të situatës aktuale të pastrimit.

6.3 Kontrata me afat deri në 5 vjet me sipërmarrësit e këtyre shërbimeve, shmang kostot administrative që mund të kishte procedura e prokurimit në mënyrë të perseritur dhe shmang riskun që sjell kryerja çdo vit e procedurës, sepse afatet e prokurimeve kërkojnë kohë e cila do të sillte si pasoje mungesën e shërbimit të pastrimit.

6.4 Me Vendimin e Këshillit të Bashkisë Pogradec Nr. 109, datë 22.11.2019, i konfirmuar me shkresën Nr. 1532/1 prot, datë 27.11.2019, të Prefektit të Qarkut Korçë, është siguruar dhe miratuar financimi shumëvjeçar për këtë shërbim.

6.5 Burimi i financimit për këtë shërbim është i parashikuar nga "Të ardhurat", që sigurohen nga tarifa e pastrimit, në këtë mënyrë financimi dhe likuidimi ndërvite është i garantuar.

6.6 Është zgjedhur kohezgjatja e kontratës në 5 vite, duke marrë në konsideratë interesin publik, duke siguruar në mënyrë sistematike dhe të strukturuar shërbimin e pastrimit, duke shmangur rrezikun që qyteti i Pogradecit dhe fshatrat në Njësitë Administrative, të mos i'u sigurohej shërbimet minimale të pastrimit dhe higjienës.

6.7 Gjithashtu, referuar kontratave të shërbimit të pastrimit dhe eksperiencës së bashkisë Pogradec, kohëzgjatje e këtyre kontratave ka qënë 5 (Pesë) vjeçare.

7. Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: 18.02.2020, ora 09.00, vendi www.app.gov.al.

8. Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: 18.02.2020, ora 09.00, vendi www.app.gov.al.